



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 186/2 Prot.

Tiranë, më 02.03. 2022

V E N D I M

Nr. 45, Datë 02.03. 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 32, datë 04.02.2022, të paraqitur nga ankuesi Sh.A.S (në vijim ankuesi) kundër Drejtuesve të Shoqatës Qatar Charity në Tiranë dhe në Doha, si dhe persona të tjerë të përfshirë në sferën diplomatike apo politike, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *etnisë, bindjes politike, bindjes filozofike dhe çdo shkak tjetër*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri),

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi deklaroi se është banues në Tiranë, me detyrë Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Albania Qatar Foundation dhe ish Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës Qatar Charity Albania (deri në datën 09.12.2021), të cilat kanë të njëjtën adresë dhe operojnë në të njëjtat ambiente tek Zogu i Zi, Tiranë.

Ankuesi deklaroi se jeton në Shqipëri që prej datës 01.06.2000. Prej vitit 2011 e në vijim është Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Albania Qatar Foundation dhe prej vitit 2014 deri më datë 09.12.2021 ka qenë njëkohësisht edhe Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës Qatar Charity Albania dhe kjo e fundit u vendos në adresën dhe ambientet ku tashmë ishte fondacioni i krijuar më herët.

Në vitin 2017, ankuesi shprehet se me Fondacionin Albania Qatar Foundation kanë filluar procedurat e blerjes së pronës ku janë zyrat dhe në 2014 në të njëjtën adresë, me anë të një kontrate huapërdorje është futur edhe Shoqata Qatar Charity Albania. Në korrik 2021, Fondacioni Albania Qatar Foundation i dhuron Shoqatës Qatar Charity pronat e paluajtshme

(zyra, garazhe, etj) me kushtin që dhuruesi, pranë fondacionit të qëndronte me kontratë huapërdorje dhe të operonte normalisht deri në afatet kontraktuale. Në këtë ambient gjenden pajisjet, mobiljet dhe dokumentacioni i nevojshëm për funksionimin e Fondacionit Albanian Qatar Foundation.

Më datë 02.12.2021, ankuesi deklaroi se, i është ndaluar hyrja në ambientet e zyrës së fondacionit nga punonjës të sigurisë me urdhër të drejtuesve të shoqatës Qatar Charity Albania. Ai ka pritur në hyrje të ambienteve për sqarime por më pas është shoqëruar nga policia ku ka dhënë shpjegimet përkatëse. Ankuesi pretendon se është shkarkuar nga detyra si drejtor i Shoqatës Qatar Charity Albania me një procedurë të nxituar dhe të dyshimtë, duke kryer veprime në kundërshtim me ligjin, statutin dhe aktin e themelimit. Kjo, sipas ankuesit ka ndodhur pasi për një periudhë disa vjeçare ai ka refuzuar t'i shërbejë politikës në punën humanitare. Gjatë këtyre viteve ka patur presion dhe tendencë që të ndihmojë, jo aty ku ka patur më shumë nevojë, por sipas orientimeve politike, si nga drejtues të Shoqatës Qatar Charity me seli në Doha por edhe Ambasada e Qatarit në Tiranë. Ata kanë insistuar që ndihma humanitare e ofruar të jepet sipas orientimeve dhe sugjerimeve të politikanëve dhe qeverisë shqiptare. Qëndrimi i mbajtur prej ankuesit e ka vendosur atë në një situatë konfliktuale me drejtues të shoqatës që drejtojnë në nivel global në Doha por edhe me Ambasadorin e shtetit të Qatarit në Tiranë. Ankuesi më tej shprehet se, përfaqësuesi i Shoqatës Qatar Charity nga Doha, Mateb Al-Marri i ka bërë të qartë dhe së fundmi në nëntor 2021 se “duhet të bëjë siç duan ata ose është i mbaruar” se “Qatar është shtet i fortë dhe në Shqipëri kanë ndikim të madh e mund të marrin masa kundër tij” se “është egjiptian dhe fjala e tij nuk ka vlerë as në Shqipëri as në Qatar përpara fjalës së një Qatarezi”.

Ankuesi shprehet se, ka punuar prej shumë vitesh dhe ka marrë lavdërime dhe nderime për punën e tij në Shqipëri, qoftë si Drejtor Ekzekutiv i Albanian Qatar Foundation, detyrë të cilën vazhdon ta ushtrojë, qoftë si Drejtor i Shoqatës Qatar Charity Albania, detyrë nga e cila është shkarkuar, sipas tij në mënyrë arbitrare dhe për shkaqe diskriminimi, jo vetëm për atë vetë, por në thelb sepse nuk ka pranuar të diskriminojë ndërmjet të varfërve. Nuk ka pranuar të diferencojë të varfërit në të majtë apo të djathtë, të varfër që preferohen nga qeveria apo bashkitë, nga ata që nuk preferohen prej tyre.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, marrjen e masave të mëposhtme:

- Të bëhet hetim i thelluar dhe i paanshëm.
- Të konstatohet diskriminimi në formë të rëndë, për disa shkaqe, ndërsektorial.
- Komisioneri të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për mbështetjen e ankuesit.
- Komisioneri t'i drejtohet opinionit publik dhe institucioneve ndërkombëtare me qëllim sensibilizimin e tyre për këtë rast diskriminimi si këmbanë alarmi për diskriminimin jo të një individi, por të njerëzve në nevojë dhe që ndikohen nga kjo “modus operandi”.
- Të zhvillojë një seancë dëgjimore publike për këtë rast.
- Të marrë masa me vendim për rivendosjen e gjendjes së mëparshme, si dhe çdo masë tjetër që heq pasojat e diskriminimit dhe pengesat për të vijuar veprimtarinë dhe ndihmën për

shtresat në nevojë pa intimidime, frikë dhe presion nga autoritete apo entitete kushdo qofshin, sipas vlerësimit të Komisionerit (pika 11, neni 33, i ligjit).

- Si mjet i fundit, nëse Komisioneri vëren moszbatim të vendimit apo neglizhencë t'i drejtohet autoriteteve për heqjen e tagrave të institucioneve, siç parasheh pika 15, e nenit 33, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Ankuesi ka depozituar ankesën pranë Komisionerit, duke pretenduar se është viktimë e diskriminimit për disa shkaqe njëkohesisht, etnisë, bindjes politike, bindjes filozofike, si dhe çdo shkak tjetër, por pa identifikuar në kuadër të këtij të fundit ndonjë shkak konkret. Sipas shpjegime të dhëna nga ankuesi, momentet e pretenduara si diskriminuese konsistojnë në:

së pari, ankuesi pretendon se është shkarkuar si Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës Qatar Charity Albania, pasi nuk ka pranuar dhe ka luftuar që aktiviteti humanitar të jetë larg ndikimit të politikës dhe duke mos bërë diferencime midis të varfërve që janë në nevojë;

së dyti, ankuesi pretendon se nuk është lejuar të hyjë në ambientet ku ushtron veprimtarinë Fondacioni Albania Qatar Foundation, Drejtori Ekzekutiv i të cilit ankuesi vazhdon që të jetë edhe aktualisht, duke mos e lejuar atë që të ushtrojë veprimtarinë e tij, pavarësisht se sipas ankuesit palët kanë midis tyre një kontratë që e lejon fondacionin e drejtuar nga ankuesi që të përdorë ambientet përkatëse.

Ankuesi pretendon se shkarkimi i tij në mënyrë arbitrare nga pozicioni si Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës Qatar Charity Albania, diskriminon në thelb të varfërit, të cilët sipas tij diferencohen nën ndikimin politik.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose **është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji**; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dëgjimit për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin

10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe të sigurojë mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë shkaqet e pretenduara nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, **etninë**, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, **bindjet politike**, fetare ose **filozofike**, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se është shkarkuar nga detyra si Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës Qatar Charity Albania nga organet drejtuese të kësaj organizate jofitimprurëse, Komisioneri vlerëson se një pretendim i tillë nuk gëzon mbrojtje nga diskriminimi sipas parashikimeve të nenit 7, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë nuk hyn në fushën e veprimtimit të këtij ligji dhe në kompetencat e Komisionerit. Komisioneri vlerëson se, mosmarrëveshjet midis organeve drejtuese të Shoqatës Qatar Charity Albania, duhet të paraqiten pranë organeve gjyqësore kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

Në lidhje me pretendimin se ankuesi nuk është lejuar të hyjë në ambientet ku ushtron veprimtarinë Fondacioni Albania Qatar Foundation, Komisioneri vlerëson se edhe ky pretendim i ankuesit nuk gëzon mbrojtje nga diskriminimi sipas parashikimeve të nenit 7, të ligjit

nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë Komisioneri nuk ka kompetencë të shqyrtojë këtë pretendim të paraqitur nga ankuesi në ankesën e tij. Referuar shpjegimeve të dhëna nga ankuesi, Komisioneri vlerëson se jemi përpara një mosmarrëveshje kontraktuale të cilën palët duhet ta paraqesin për zgjidhje përpara organeve gjyqësore.

Në kontekst të legjitimitetit të ankimit kundrejt Amasadës së Qatarit në Shqipëri, ndaj të cilës ankuesi ka ngritur pretendime për diskriminim, Komisioneri vëren se, ky subjekt përfshihet tek subjektet që gëzojnë imunitet kundrejt proceseve administrative që mund të ndërmerren ndaj tyre nga vendi pritës. Në këtë kuadër nuk mund t'i nënshtrohet hetimit administrativ pranë Komisionerit.

Kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, lidhur me sa më sipër, parashikon si më poshtë:

Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: “Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: “a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.

Neni 122 i Kushtetutës përcakton se: “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë. 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.”

Konventa e Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”(Konventa) ka hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998. Neni 31 i Konventës ka përcaktuar se: “1. Agjenti diplomatik gëzon imunitetin e juridiksionit penal të Shtetit pritës. Ai gëzon gjithashtu imunitetin e juridiksionit të tij civil dhe administrativ, përveç kur bëhet fjalë: a) për një veprim real lidhur me një ndërtesë private që ndodhet në territorin e Shtetit pritës, përveç kur agjenti diplomatik e posedon atë për llogari të Shtetit akreditues për qëllimet e misionit. b) për një veprim lidhur me një trashëgimi në të cilin agjenti diplomatik figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar ose legatar, si privat dhe jo në emër të Shtetit akreditues. c) për një veprim lidhur me një profesion të lirë ose me një aktivitet tregtar çfarëdo qoftë, të ushtruar nga agjenti diplomatik në Shtetin pritës jashtë funksioneve të tij zyrtare. 2. Agjenti diplomatik nuk është i detyruar të japë dëshminë e tij. 3. Asnjë masë zbatimi nuk mund të merret karshi agjentit diplomatik, me përjashtim të rasteve të

parashikuara në pikat a), b) dhe c) të paragrafit të parë të këtij neni, dhe me kusht që zbatimi të kryhet pa cenuar paprekshmërinë e personit të tij ose të banesës së tij”.

Aktet ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar, të tilla si Karta e OKB-së dhe Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (e vitit 1961, hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998), Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore (1963), Konventa për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjensive të Specializuara dhe anekset e saj, si dhe marrëveshjet dy palëshe të ndryshme të lidhura mes shtetit Shqiptar dhe shteteve të tjera, përcaktojnë rrethin e subjekteve që janë të përjashtuar nga juridiksioni territorial i brendshëm gjyqësor dhe administrativ dhe, si pasojë, nuk mund të jenë subjekte të padive, kërtimeve apo procedurave të ekzekutimit në vendin tonë. Përjashtimi nga juridiksioni territorial i vendit pritës, Shqipërisë, përfshin të gjitha funksionet zyrtare të këtyre subjekteve dhe është i paprekshëm¹.

Marrëveshjet ndërkombëtare sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 116), kanë një status superior ndaj ligjeve. Ligji shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë njohin dhe pranojnë mungesën e juridiksionit të gjykatave shqiptare, për shkak të imunitetit që gëzon njëra prej palëve në mosmarrëveshje si subjekt i posaçëm parashikuar në një marrëveshje/konvente dy ose shumëpalëshe. Bazuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, evidentohet se e drejta e aksesit në gjykatën kombëtare i'u nënshtrohet rregullimeve kufizuese për aq sa këto kufizime nuk reduktojnë aksesin e individit në gjykatat kombëtare në një mënyrë të tillë, apo në atë masë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës. Dhënia e imunitetit palës së paditur në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe legjislacionit në fuqi nuk mund të thuhet se tejkalon marzhin e vlerësimit që shtetit shqiptar i lejohet në kufizimin e aksesit të individit në gjykatë. Kjo bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, sipas së cilës “... disa kufizime mbi aksesin (në gjykatë) duhet të konsiderohen si të qënësishme, si për shembull ato kufizime që përgjithësisht pranohen nga komuniteti i shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror”².

Në një rast të ngjashëm, për përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njehsues se, kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, sipas Marrëveshjes Dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.06.1992, janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, pavarësisht nga ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion

¹ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011.

² MvElhinney kundër Irlandës [GC], nr.31253/96, § 37, ECHR 2001-XI; Manolescu dhe Dobrescu, (dec.), nr.60861/00, § 80, ECHR 2005-VI; Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë (dec.), nr.26937/04, ECHR 2006; Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë nr.35720/04 dhe 42832/06, § 44-47 ECHR 2009.

për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga këto marrëdhënie, përveç rasteve kur është pranuar juridiksioni i gjykatave shqiptare vullnetarisht³.

Anëtarët e përfaqësive diplomatike nuk janë nën juridiksionin gjyqësor shqiptar, vetëm nëse ata e pranojnë këtë me vullnetin e tyre. Ky përjashtim nga juridiksioni shqiptar është i parashikuar në nenin 39 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet juridiksioni ndaj përfaqësuesve diplomatik e konsullorë: *“Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare. Ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”.*

Sa më sipër, konform nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenit 3 të Ligjit nr. 9105, datë 17.07.2003, *“Për Aderimin e Shqipërisë në Konventën Për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara dhe Aneksat e saj”*, konstatohet dhe pranohet mungesa e juridiksionit gjyqësor. Gjykatat janë institucionet pranë të cilave mund të kundërshtohen aktet administrative të organeve të administratës shtetërore, ndër të cilat edhe vendimmarrja e Komisionerit.

Po ashtu, neni 31/1 i Konventës së Vjenës *“Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”*, ka përcaktuar qartë gëzimin e imunitetit të agjentit diplomatik edhe përsa i takon juridiksionit administrativ.

Në këtë kontekst, Komisioneri, konstaton mungesën e juridiksionit administrativ dhe kompetencës mbi subjektin e Ambasadës së Qatarit, për sa kohë edhe vetë gjykata, ka pranuar mungesën e juridiksionit gjyqësor lidhur me shqyrtimin e çështjeve me palë ambasadat e huaja në territorin e Shqipërisë.

Në kontekst të legjitimitetit të ankimit kundrejt drejtuesve të shoqatës Qatar Charity në Doha, ndaj të cilëve ankuesi ka ngritur pretendime për diskriminim, Komisioneri vëren se, ky subjekt nuk përfshihet tek subjektet ndaj të cilëve gjen zbatim ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili në nenin 4, të tij, përcakton: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në neni 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi Sh.A.S, nuk mund të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

³ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 32 regj., datë 04.02.2022, të paraqitur nga ankuesi Sh.A.S, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku : Etnia, bindjet politike, bindjet filozofike, çdo shkak tjetër
Lloji i vendimit: Mospranim